



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i Biznesit: "Audiovideo" SH.P.K. -
Numri Unik Identifikues: 810824278
Pronar: Burim Krasniqi
Emri i OSHMA-së: MBTV
Adresa: Rr/UI/Str/ Qendra Tregtare Dardania, nr. LS 1A



VENDIM

lidhur me ripërtëritjen e licencës të Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audiovizuale "MBTV" me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, me seli në Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. OSHMA "MBTV" është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA), i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetimin e programeve televizive përmes sistemit të operatorëve të shpërndarjes. KPM, me datën 06 qershor 2013, ka marr vendim për dhënien e licencës për OSHMA MBTV.
3. Me datën 06 qershor 2023, skadon afati i licencës për MBTV, ndërsa, në bazë të nenit 25 të Ligjit për KPM-në, kandidatit i ofrohet e drejta të kërkojë ripërtëritjen e licencës në afat brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.
4. Me datën 18 prill 2023, KPM përmes e-mail u ka dërguar shkresë të gjithë ofrueseve të shërbimeve mediale audiovizuale me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes të cilave afati i licencës ju skadon në vitin 2023, në mesin e tyre edhe OSHMA MBTV për t'ju rikujtuar skadimin e afatin të licencës dhe mundësin për ripërtëritjen e saj në pajtim me Nenin 25 të Ligji Nr. 04/L-44 për Komision i Pavarur të Mediave.
5. Më 11 maj 2023, OSHMA MBTV ka parashtruar kërkesën në zyrën e KPM-së, me anë të së cilës ka shprehur interesimin për ripërtëritje të Licencës së KPM-së.
6. Për shkak të mungesës së kuorumit për vendimmartje të Komisionit të Pavarur të Mediave, nga data 15 tetor 2022 deri më datën 6 qershor 2023, kërkesa e kandidatit OSHMA "MBTV", nuk ka arritur të shqyrtohet me kohë.

Arsyetimi

7. OSHMA "MBTV", ka parashtruar kërkesën për ripërtëritje të licencës së KPM-së pas skadimit të afatit për aplikim brenda afatit të përcaktuar ligjor. Pronari Burim Krasniqi është arsyetuar se në muajt e fundit ka udhëtuar jashtë vendit për shkaqe shëndetësore.
8. Komisioni konstaton se OSHMA "MBTV" nuk ka obligime financiare ndaj KPM - së.
9. Komisioni KPM-së konsideron se nuk janë evidentuar shkelja të tilla të dispozitave materiale të Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së, nga ana e ofruesit të shërbimit medial, OSHMA "MBTV" të cilat shkelje do të pamundësonin ripërtëritje e licencë
10. Neni 25 i Ligjit për KPM-në, krijon bazën ligjore që të ripërtërijë licencën e kandidatëve të cilët kanë parashtruar kërkesën për ripërtëritje në pajtim me Ligjin për KPM-në si më poshtë:

"Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtëritet për shkak të shkeljes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit të shërbimit medial audiovizuel privat për sa u përket kushteve dhe kritereve të licencimit, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Komisioni brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës",

Vendim

11. Komisioni në takimin e datës 17 korrik 2023, vendos që kandidatit OSHMA "MBTV" me seli në Prishtinë, t'i ripërtërijë licencën për të vepruar si Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes në Republikën e Kosovës.
12. Licenca e OSHMA "MBTV" do të jetë e vlefshme për një afat prej dhjetë (10) vitesh, ashtu siç është përcaktuar me Nenin 21, paragrafin 2, të Ligjit për KPM-në, ndërsa vlefshmëria e afatit të licencës do të llogaritet nga data 6 qershor 2023.
13. Të gjitha parametrat e licencës së OSHMA "MBTV" do të mbesin të pandryshuar nga licenca paraprake.
14. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.



Jeton Mehmeti

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



17.07.2023

datë